



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1032 Prot.
7

Patos më 07.04.2026.

PROCESVERBAL

MBI MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS SË MBLEDHJES SË DATËS 31.03.2026

I mbajtur sot më datë 31.03.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit ku zhvillohet mbledhja e Këshillit të Bashkisë:

Prezent në fillimin e mbledhjes këta këshilltare:

1. Klaudio Alisininaj
2. Lori Musaj
3. Artan Velçani
4. Armand Ahmetaj
5. Ertilla Myrtaj
6. Suela Hoxha
7. Smerald Hazizaj
8. Elmira Rama
9. Renaldo Shpata
10. Novrus Toska
11. Gani Ahmetaj
12. Shezai Sinanaj
13. Zejni Musaj

Takimi hapet nga kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj.

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,
I nderuar Kryetar

Jemi në mbledhjen e këshillit bashkiak e cila bazohet në nenin 53 pika 4 dhe 56 pika 2 gërma a të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", si dhe në Rregulloren për Organizimin dhe Funksonimin e Këshillit Bashkiak.

Pjesmarrja në mbledhje është 13 këshilltarë.

Armand Ahmetaj- Lexojmë rendin e ditës

- 1- Miratimi i rendit të ditës.
- 2- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 25.02.2026.
- 3- Informacion mbi vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 25.02.2026.
- 4- Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin shkurt 2026".

- 5- Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin shkurt 2026".
- 6- Projekt-vendim "Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të projekt Buxhetit Afatmesëm 2027-2029".
- 7- Informacion mbi nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve të inventarit të vitit 2025..
- 8- Projekt-vendim "Për një ndryshim të V.K.B nr. 57, datë 22.09.2025 "Përmirësim i paketës së shtresave asfaltike në rrugët " Heronjtë e Linasit, "Shpiragu" dhe degëzim i rrugës " Sulo Goxhaj".
- 9- Raporti vjetor i punës së këshillit të bashkisë Patos për vitin 2025.

Armand Ahmetaj- Para se të kalojmë për miratimin e rendit të ditës dua tju pyes nëse keni ndonjë propozim për të hequr ose për të shtuar ndonjë çështje?


Kush është dakord me rendin e ditës ?

Miratohet me 13 vota pro, asnjë abstenim, asnjë kundër.

SEKRETARE

Refaela Xeba



Lori Musaj
Benedto Shpato
Smerqol Hoziraj


KRYETAR

Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1032 Prot.

18

Patos më 07.04.2026

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 31.03.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dytë të rendit të ditës.

Armand Ahmetaj- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 25.02.2026.
Procesverbalin e keni patur si material në emailin tuaj, e keni lexuar, Keni ndonjë vërejtje?
Armand Ahmetaj –Nuk keni. Atëherë në bazë të nenit 77 konsiderohet i votuar pro .

SEKRETARE

Refaela Xeba

Lori Musaj Haf

Remolito Djurata

Smekrofol Hazizod

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1032 / Prot. 19

Patos më, 07 04.2026

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 31.03.2026 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tretë të rendit të ditës.

Informacion mbi vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 25.02.2026.

Armand Ahmetaj – Fjala për Refaelën
Refaela Xeba -Përshëndetje të gjithëve!

Në mbledhjen e datës 25.02.2026 u morën gjithsej 9 vendime nga nr. 07 deri ne 15 .

Vendimet janë zbardhur në afat dhe i janë përcjell drejtorive përkatëse për ekzekutim.

Faleminderit!

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj

Lori Musaj
Rendoloto Shyato
Smerodol Hoxha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 994 Prot.
13

Patos më 07 04.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 31.03.2026 në orën 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së katërt të rendit të ditës.

Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin shkurt 2026".

Armand Ahmetaj- Kjo pikë ka kaluar për shqyrtim në komisionin e ekonomisë, kryetari të shprehet pasi të kemi fjalën e ekzekutivit.

Klaudio Alisanaj - raportin e vendimarrjes së komisionit po e bëj unë si sekretar, Komisioni u mblodh në datën 30 dhe pasi shqyrtoi propozimin e bërë nga ekzekutivi "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë" e miratoi me tre vota pro.

Armand Ahmetaj- Keni ndonjë diskutim tjetër?

Armand Ahmetaj –Nëse s'kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e katërt Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin shkurt 2026".

Kush është dakord?

Miratohet me 13 vota pro, abstenim ska, kundër ska

SEKRETARE
Refaela Xeba

Lori Musaj
Rendato Duro
Smerodol Hoxha

KRYETAR
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 998/13 Prot.

Patos më 07 04.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 31.03.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së pestë të rendit të ditës.

Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin shkurt 2026".

Klaudio Alisananaj - Dhe ky projektvendim u trajtua në komision dhe pas dëgjimit të bërë nga ekzekutivi arritëm në përfundimin e mitatimit me tre vota pro.

Armand Ahmetaj- Keni ndonjë pyetje?

Armand Ahmetaj –Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e pestë Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin shkurt 2026".

Armand Ahmetaj –Kush është dakord?

Miratohet me 13 vota pro, abstenim ska, kundër ska.

SEKRETARE
Refaela Xeba

Lori Musaj Myf.
Remaldo Shyete
Smendrel Hozitaj

KRYETAR
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1039 Prot.

Patos më 07.04.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 31.03.2026 në orën 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së gjashtë të rendit të ditës.

Projekt-vendim "Për miratimin e taveve përgatitore të shpenzimeve të projekt Buxhetit Afatmesëm 2027-2029".

Mimoza Shtëmbari – Siç ju të gjithë jeni bërë pjesë e buxhetimit ka filluar faza e buxhetit afatmesëm 2027-2029, ka filluar me miratimin dhe vlersimin e të ardhurave në muajin shkurt. Të ardhurat e miratuara me vendim këshilli janë shpërndarë në tavanet buxhetor për pesë programe. Bashkelidhur projektvendimit është relacioni ku janë pasqyruar të detajuara burimet dhe shpenzimet. Buxheti për çdo vit është i balancuar. Në krahasim me vitin 2026 kemi një rritje të transfertës me 1.4% e cila është shpërndarë në shpenzime personeli për të ruajtur këto politikat për rritjen e pagave për vendimet që nxjer pushteti qendror. Të analizuarat zë për zë janë:

Buxheti për vitin 2027 arrin 744 milion 528 mijë i cili përbëhet nga tre burimet transferata e pakushtëzuar sektoriale dhe të ardhurat vendore të shpërndara në shpenzime personeli 337 milion dhe sigurimet shoqerore 56 milion.

136 milion 279 shpenzime operative dhe 198 395 shpenzime kapitale të cilat janë të miratuara me këtë nivel edhe në vitin 2027 me PBA e 2026-2028. Tavanet për vitin 2028 buxheti është 754 056 kemi ruajtur të njëjtat shpenzime personeli dhe shpenzimet kapitale vijne me një rritje me vlerën 206 milion 846 mijë. Tavanet për vitin 2029 janë me burimet që zënë vlerën e të ardhurave 763 milion 809 mijë të ruajtura me një rritje siç thash të shpenzimet e personelit e ndërkohë pjesa tjetër është rritur shpenzime kapitale me 214 milion 965 në total.

Këto ishin tavanet, relacioni i ka tavanet për çdo program për të gjitha shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik dhe funksioneve.

Klaudjo Alisinanaj - Dhe ky projektvendim u trajtua në komision dhe si përfundimin e votuam me tre vota pro.

Armand Ahmetaj- Nëse s'kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e gjashtë Projekt-vendim "Për miratimin e taveve përgatitore të shpenzimeve të projekt Buxhetit Afatmesëm 2027-2029".

Armand Ahmetaj –Kush është dakord ?

Miratohet me 13 vota pro, abstenim ska, kundër ska.

SEKRETARE
Refaela Xeba

Lori Musaj
Renaldo Shyete
Smajl Hoxha

KRYETAR
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 10291 Prot.

3

Patos më 07 04.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 31.03.2026 në orën 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së shtatë të rendit të ditës.

Informacion mbi nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve të inventarit të vitit 2025..

Mimoza Shtëmbari- Bashkia e ka filluar fazën e inventarizimit dhe vlerësimin e aktiveve në muajin nëntor dhe dhjetor është përfunduar gjithë faza e inventarizimit. Aty ka kaluar në komisionet përkatëse mbase ka kaluar relacionet te nënpunësi zbatues dhe autorizues dhe me vendim të nënpunësit autorizues kemi paraqitur dhe informojmë këshillin se kemi këto inventare të vlerësuara për jashtë përdorimit. Në llogarinë 327 ashtu si e sqarova dhe në komision llogaria 327 për anën proceduriale informohet këshilli por që kjo vlerë është gjithmonë e nxjerë jashtë përdorimit me zbatimim të udhëzimit sepse e ka përdorimin deri në 1 vit kurse zërat e tjerë i përkasin llogarisë kontabël 218 që është inventarët informatik dhe 218/2 inventar ekonomik. Nga inventarizimet e të gjithë institucioneve arsimore dhe administrative kemi këto vlera. Në llogarinë 327 që është inventari imët informojmë këshillin që kemi për të nxjer jashtë përdorimit të vlerësuara 766 mijë lekë. Në llogarinë inventar informatik 1 milion e 384 mijë lekë, në inventar ekonomik që bëhet nga tavolina, Karrige të institucioneve siç thash arsimore dhe administrative 6.5 milion. Vlerën më të madhe në invenatin ekonomik e zë në vlerat e shkollës Sotir Çapo dhe Kopshti nr. 2 të cilat po bëhet rikonstruksioni i plotë dhe do të mobilohen me gjithë inventarët e rinj. Informojmë këshillin që këto materiale vazhdojnë me fazën e asgjësimit ku për ato pjesë që vlerësohen për ndryshim destinacioni ose për përdorim të mëtejshëm bëhen hyrje si materiale drurësore që përdoren nga ndërmarja vartëse për ristela ose për përdorimin e tyre për pjesët e prodhimit të materialeve të ndertimit. Bashkëlidhur relacionit është cdo institucion dhe element i inventarit që del jashtë përdorimit të cilat janë konfirmuar dhe nga specialist IT për pjesën e inventarit informatik pasi nga vlerësimi që kemi bërë ne me komisionet dhe nga specialistet, kostoja që të mirëmbajmë këto pajisje është më e lartë se blerja e pajisjeve të reja.

SEKRETARE

Refaela Xeba

Lori Musaj
Rendola Shyqto
Smerqel Hazizod

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1028 Prot.
2

Patos më 04 04.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 31.03.2026 në orën 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim "Për një ndryshim të V.K.B nr. 57, datë 22.09.2025 "Përmirësim i paketës së shtresave asfaltike në rrugët " Heronjtë e Linasit, "Shpiragu" dhe degëzim i rrugës " Sulo Goxhaj".

Boreta Murati- po ju paraqesim projektvendimin nr. 18 datë 19.03.2026 për një ndryshim të vendimit nr. 57, datë 22.09.2025 "Për miratimin e zbatimit të projektit përmirësimi i paketës së shtresave asfaltike në rrugët "Heronjtë e Linasit", "Shpiragu" dhe degëzim i rrugës "Sulo Goxhaj" në mbështetje të ligjit nr. 139, date 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, nenit 4 dhe 24 të ligjit nr. 9936, date 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 10 296, date 08.07.2010 "Për Menaxhmin Financiar dhe Kontrollin", kreut VII-të të ligjit nr. 68, date 27.04.2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", VKB nr. 82, date 17/12/2025 "Mbi miratimin e numrit të pergjithshëm të punonjesve dhe buxhetin e bashkisë Patos për vitin 2026",

Në zbatim të planit buxhetor afatmesem të Bashkisë Patos për vitin 2026 është parashikuar zëri buxhetor "Përmirësimi i paketës së shtresave asfaltike në rrugën "Sulo Goxhaj", më fal Heronjtë e Linast rruga "Shpiragu" dhe degëzim i rrugës "Sulo Goxhaj" me vlerë projekti 17,249,702.79 leke.

Bashkia Patos ka zhvilluar dëgjuesën publike me nr. 3174/8 prot., date 26/11/2025, mbi planifikimin e buxhetit ku përfshihen nderhyrjet infrastrukturore për territorin e Njesisë Administrative Patos nga ka rezultuar se një nga nevojat për nderhyrje është zgjerimi i rrugës Shëtitorja dhe përmirësimi i shtresave asfaltike në rrugën "Sulo Goxhaj" deri tek kryqezimi i rrugës Demokracia, pra rruga Sulo Goxhaj fillon nga degëzimi i rrugës shëtitorja deri në kryqëzimin e rrugës Demokracia i cili nuk është buxhetuar në fazën fillestare. Pas rishikimit të projekteve është vërejtur se vlera e parashikuar në fazën fillestare për projektet është me e lartë se vlera reale e zbatimit

Pas verifikimit të ushtruar në terren mbi gjendjen ekzistuese si dhe nevojës për përmirësimin e trafikut dhe qarkullimit në rrugën "Shëtitorja" është menduar ndërhyrja për përmirësimin e infrastrukturës rrugore konkretisht në 2 segmente

1. Përmirësimi i shtresave asfaltike në rrugën "Sulo Goxhaj" me fillim ku takohet me rrugën "Shëtitorja" dhe mbarimi në kryqezim me rrugën "Demokracia". Ndërhyrjet synojnë rritjen e sigurisë dhe cilësisë së qarkullimit, si edhe përmirësimin e strukturës së rrugës për shkak të dëmtimit nga investimet si ujësjells.

2. Zgjerimi i rrugës "Shëtitorja", e cila për shkak të ngarkesës së qarkullimit sjell bllokime të shpeshta dhe ngadalësim të lëvizjes së mjeteve në këtë aks.

Me zgjerimin e karrexhatës do të mundesohet organizimi me i mire i trafikut duke krijuar një korsi të dedikuar vetëm për parkim, si dhe duke krijuar një levizje me të lire për mjetet.

Pra në total me projektin "Përmirësimi i shtresës asfaltike në disa segmente në qytet do të përfshihen 3 segmentet që ishin parashikuar në projektin "Përmirësimi i paketës së shtresave asfaltike në rrugën "Heronjtë e Linasit", rruga "Shpiragu" dhe degëzim i rrugës "Sulo Goxhaj"

Degezimi i rrugës "Sulo Goxhaj" është në afërsi të rrugës Unaza në lagjen Naftëtari dhe do të shtohen dy segmentet rrugore si rruga "Sulo Goxhaj" me fillim ku kryqëzohet me rrugën "Shetitortja" dhe mbarim ku kryqëzohet me rrugën "Demokracia", me gjatësi L=245m.

Zgjerimi i rrugës "Shetitortja", me gjatësi L=225m.

Vlera e parashikuar për realizimin e këtij projekti në total është 28,135,882.43 lekë.

Financimi i këtij objekti do të mbulohet brenda shpenzimeve kapitale të miratuara në këtë program midis vlerës së projekteve të miratuara në programin "Zhvillimi Ekonomik dhe Rural" për vitin 2026-2027.

Pra i kërkojmë këshillit të bashkisë Patos të miratojë ndryshimin e emërimit të objektit NGA "Permirësimi i paketës së shtresave asfaltike në rrugët "Heronjtë e Linasit", "Shpiragu" dhe Degezimi i rrugës "Sulo Goxhaj" në emërtimin "Përmirësimi i shtresës asfaltike në disa segmente në qytet" me përbërjen e segmenteve si i citova më sipër si dhe shtimin e vlerës së projektit 10,164,192.4 leke (përfshihet vlera e mbikqyrjes dhe kolaudimit në total për të gjithë projektin) dhe vlera totale e projektit është 28,135,882.43 lekë

Financimi do të mbulohet brenda shpenzimeve kapitale të miratuara brenda programit midis vlerës së projektit të miratuar në program të ndara 3,000,000 lekë do të pakësohen nga fondi i zërit buxhetor "Studim, projektim dhe hartim i PDV-ve"

Është një lapsus në fakt kjo 17,400,000 lekë nga çlirimi i fondit në objektin "Rikonstruksioneve të blloqeve të banimit në lagjen 1 Maj" është një vlerë më e vogël. Është 16,590,433.2 lekë nga çlirimi i fondit në objektin "Rikonstruksioneve të blloqeve të banimit në lagjen 1 Maj 4,900,000 lekë do të transferohen nga "Rikualifikimi urban sheshi para ish-bashkisë".

Artan Velçani - Komisioni u mbodh ditën e djeshme në datën 30 ora 12 vlerësoi se projektvendimi është në përputhje me ligjin dhe e miratoi atë me 3 vota por në këtë rast dhe si kryetar grupi dhe si kryetar komisioni desha të jepja një opinion. Opinioni buron dhe nga shqetësimi i qytetarëve qysh në momentin kur është bërë projekti parë ndoshta atëherë për arsye dhe qëllime të mira u bë ai projekt që është, në fakt zbatimi konkret në të sollti shumë problematika. Edhe pse me çlirimin e rrugës shetitores kryesore Republika nuk është mundur deri më sot që të përmirësohet trafiku i mjeteve. Kështu që jap dhe opinionin e qytetarëve që kjo është një gjë shumë e mirë që bashkia më në fund vendosi të ndërhyjë dhe meqenëse fondet këtu janë brenda programit nuk kemi ndonjë shqetësim të madh në këtë situatë pra nuk është se bashkia ngarkohet me kosto të tjera por edhe një opinion tjetër të paktën në vëmendjen time dy rrugët e tjera nuk e di për këtë të Shpiragut por dy rrugë që ndërhyjnë ato segmente si Heronjtë e Linasit dhe kjo Sulo Goxhaj janë investime të bëra që në kohën kur ishte deputet z. Ylli Bufi pra ka ardhur momenti që ato janë të vërejtura dhe me sy që kishin problematika të theksuara dhe duhej ndërhyrë për sistemin riasfaltim.

Kryetari Bashkisë- Përsa i përket vlerës 4.9 milion do meren nga Rikualifikimi para pallatit të kulturës

3 milion do meren nga projekte të ndryshme hartim projekteve dhe i PDV-ve dhe diferenca do të plotësohet nga pjesa e mbetur e fondit të investimit në lagjen 1 Maj. Ndërsa pjesa e rrugës Shpiragu, degëzimi i rrugës Sulo Goxhaj është pjesa të lagjia Naftëtari mbas pallatit të fundit që u bë me fasad në sistem kapot. Pallati fundit që kufizohet me lagjen Naftëtari me lagjen 1 Maj, pjesa mbrapa atij pallati që u bë hapja e hapësirave publike dhe tani është pjesa për rehabilitimin e saj. Zgjerimi i rrugës kryesore nga degëzimi që lidhet me rrugën që del për te stadiumi që dhe ajo është për të riveshur deri te rruga që zbret poshtë te ujvara apo te shkallët që ngjitesh për lart të pista. Deri atje është pjesa që do të zgjerohet nga rruga kryesore dhe do të gërvishen dy rrugët kryesore Sulo Goxhaj që fillon aty dhe deri në lidhje me unazën dhe pjesa tjetër rruga që del deri te stadiumi. E theksojmë që është vetëm pjesa e sipërme asfaltike riveshje jo trajtime të tjera.

Artan Velçani- Për të shtuar në e biseduam me Borën dje dhe nuk e di projektin nga pamja vizuale nuk e kemi parë po unë e kam merak atë tek pjesa e bryllit, ja thash edhe Borës dje gjithsesi është çështje e projektit ajo, që ajo kthesa aty që ne i themi para shatërvanit të ish farmacia të zbutet cik do ishte gjë e mirë.

Ajo është bërë më pas se këto të tjerat

Kryetari Bashkisë- Ajo është bërë fare, ajo fillon aty dhe del tek kopshti, është pjesa që nuk është bërë se pjesa që është bërë është në rregull, nuk ka asnjë problem, domethënë fillon ku ka qënë ai

dyqani Arbenit deri te shtëpitë e Timos, është segmenti që është parashikuar për tu bërë me asfalt ndërsa pjesa tjetër është jashtë pjesës së projektit që do bëhet nga punjonjësit e Ndërmarjes së Shërbimeve

Atëherë propozoi ta kalojmë në votim pikën tetë Projekt-vendim "Projekt-vendim "Për një ndryshim të V.K.B nr. 57, datë 22.09.2025 "Përmirësim i paketës së shtresave asfaltike në rrugët " Heronjtë e Linasit, "Shpiragu" dhe degëzim i rrugës " Sulo Goxhaj".

Armand Ahmetaj –Kush është dakord?

Miratohet me 13 vota pro, abstenim ska, kundër ska.

SEKRETARE

Refaela Xeba



Lori Musaj


Renaldo Shyeta

Smerod Hoxhaj



KRYETAR

Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 10311 Prot.

Patos më 02 04.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 31.03.2026 në orën 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së nentë të rendit të ditës.

Raporti vjetor i punës së këshillit të bashkisë Patos për vitin 2025.

Artan Velçani - Ky informacion do publikohet në web dhe unë mendoj që ta kalojmë

Armand Ahmetaj- Konkretisht ti propozon që ta kalojmë pa e lexuar

Elmira Rama- Analizën e punës së këshillit e lexova, është një analizë e punës së këshillit në tërësi të funksionit të këshillit por doja të ndalesha pak te roli i këshilltarit duke i referuar analizës së punës simë individuale e cila përceptohet nga qytetarët si jo në nivelin e duhur dhe në përmbushje të këtij roli unë dua të kërkoj bashkëpunimin me administratën e bashkisë për ta vlerësuar më shumë rolin e këshilltarit dhe mbi të gjitha për ti trajtuar me seriozitet çështjet dhe problematikat që në përcjellim.

Armand Ahmetaj – Faleminderit mesazhi u përcoll

SEKRETARE

Refaela Xeba

Lori Musaj

KRYETAR

Armand Ahmetaj

Renaldo Spota

Smerodolj Haziraj